
WEnerg Sh.a

RAPORTI I DHENIES SE SIGURISE I AUDITUESIT LIGJOR

Mbi shumat e detyrimeve te shoqerise "WEnerg" sh.a
per aksionarin **CN'AIR SAS**, qe do te perdoren per shlyerjen e kontributit per zmadhimin e kapitalit
themeltar te shoqerise "WEnerg" sh.a,
si dhe per zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise duke perthithur humbjet e mbartura deri ne
31.12.2022

Permbajtja

PERMBAJTJA:

RAPORT I DHENIES SIGURISE I AUDITUESIT TE PAVARUR	3
PASQYRA E LLOGARITJEVE TE AKSIONEVE TE KAPITALIT PER EFEKTE TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR DHE ZVOGELIMIT PER MBULIMIN E HUMBJEVE TE MBARTURA.....	5
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PER QELLIM TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR.....	8
1. Te dhena te Pergjithshme mbi Shoqerine	8
2. Te Dhena Per Zmadhimin e Kapitalit	8
3. Politikat Kontabel Per Pasqyrimin e Huave ne Pasqyrat Financiare	8

RAPORT I DHENIES SIGURISE I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar:

ASAMBLESE SE AKSIONAREVE TE SHOQERISE

“WEnerg”sh.a

Qellimi i Angazhimit:

Asambleja e aksionarëve të shoqërisë me vendim të datës 01/12/2023 na ka angazhuar si auditues ligjor për të verifikuar dhe për të dhënë siguri të arsyeshme mbi përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të shumave dhe mundësive të zmadhimit të kapitalit duke përdorur si burim konvertimin e huasë kundrejt aksionarit CN'AIR SAS ne kapital themeltar. Gjithashtu asambleja e aksionareve të shoqërisë na ka angazhuar si auditues ligjor për të dhënë siguri të arsyeshme mbi përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të shumave të zvogelimit të kapitalit themeltar për të mbuluar humbjet e mbartura deri në 31.12.2022.

Kriteret

Si baze për angazhimin e verifikimit të zmadhimit të kapitalit ne kemi përdorur Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjin Nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë “WEnerg”sh.a, të periudhës kontabël të mbyllur më 31 dhjetor 2022, janë audituar, keto pasqyra financiare janë përdorur në angazhimin tonë.

Aksionari CN'AIR i ka dhënë një financim Shoqërisë “WEnerg”sh.a, e cila paraqitet në vlerën 5,511,527 Euro, ose 629,581,713 Leke me 31.12.2022.

Ne jemi njohur me Vendimin e asamblese të shoqërisë për zmadhimin në parim të kapitalit dhe njëkohësisht zvogelimin e kapitalit themeltar për të mbuluar humbjet e mbartura deri në 31.12.2022.

Pergjegjesia e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në përputhje me kriteret e sipërpërmendura. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabile; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabile të arsyeshme për rrethanat financiare.

Pergjegjesia jonë

Pergjegjesia jonë është që ne përputhje me Vendimin e Asamblese së Aksionareve të datës 01.12.2023, bazuar në procedurat e kryera, të shprehim një opinion mbi shumën e detyrimit të shoqërisë Shoqërisë “WEnerg”sh.a ndaj aksionarit CN'AIR në 31.12.2022 të pasqyruar kjo në pasqyrat financiare të shoqërisë në 31.12.2022.

Ne e kryem auditimin në pajtim me Standardet Nderkombëtare të Angazhimeve të Dhenies së Sigurise (SNAS 3000) “Angazhimet të dhenies së Sigurise që ndryshojnë nga Auditimet apo rishikimet e Informacioneve Financiare Historike” dhe standardet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë. Keto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë procedurat e nevojshme për të siguruar një nivel sigurie të arsyeshme që informacionet të përgatitura nga drejtimi i shoqërisë për kapitalet e veta janë të vërteta dhe të sinqerta, në të gjitha aspektet materiale.

Procedurat e kryera nga ana jonë për këtë angazhim përfshijnë:

1. Verifikimin e përputhshmërisë së shifrave në pasqyrën e Detyrimit për Aksionarin CN'AIR me ato të Pasqyrave financiare të vitit ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2022 si edhe gjendja e detyrimit deri në 01.12.2023 date në të cilën është marrë vendimi nga aksionaret.
2. Verifikimin e mjaftueshmërisë së huasë së dhënë nga aksionari CN'AIR për të shlyer aksionet e reja të emetuara për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “WEnerg”sh.a.
3. Verifikimin e llogaritjeve për numrin e aksioneve si efekt të zmadhimit të kapitalit themeltar.
4. Verifikimin e llogaritjeve për vlerën e aksioneve si efekt të zvogelimit të kapitalit themeltar si pasoje e perthithjes së të humbjeve të mbartura deri në 31.12.2022 në vlerën 500,934,402 Leke.

Konkluzioni

1. Bazuar ne procedurat e verifikimeve te kryera, shuma e huase nga aksionari CN' AIR eshte si me poshte:

	<u>Shuma e</u> <u>Detyrimit ne Euro</u>	<u>Shuma e</u> <u>Detyrimit ne All</u>
Detyrimi deri 31/12/2022	5,511,527	629,581,713
Shlyerje nga 01/01/2023 deri ne date 01/12/2023	-	-
Efekte nga kursi I kembimit		(67,881,713) ¹
Gjendja e detyrimit ne 01/12/2023	5,511,527	561,700,000

Keto shuma rakordojne me llogaritë përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës që ne verifikuam. Pasqyra Financiare e Detyrimit, per qellim te zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise, si dhe shenimet e lidhura me to, japin nje paqyrim të sinqertë dhe te vertete te gjendjes se huase qe aksionari CN' AIR i ka dhene shoqerise Wenerg sha.

- Shuma e huase se dhene nga aksionari CN' AIR eshte e mjaftueshme per te shlyer kontributin e nevojshem per zmadhimin e kapitalit ne masen 561,700,000 leke.
- Llogaritjet e bera për të përcaktuar shtesen e kapitalit nepermjet emetimit te 56,170 aksione te reja me vlere nominale te nje aksioni 10,000 lekë/aksion, pasqyrojne me vertetesi raportin e kembimit te huase ne kapital te shoqerise.
- Llogaritjet e bera per te percaktuar zvogelimin e kapitalit nepermjet perthithjes se humbjes se mbartur, nepermjet uljes se vleres nominale te nje aksioni nga 10,000 Leke/ aksion ne 1,756.88 Leke per aksion, pasqyrojne me vertetesi raportin e kembimit te huase ne kapital te shoqerise.
- Mbas emetimit te 56,170 aksioneve te reja me vlere nominale 10,000 leke/aksion te cilat shlyhen 100% nga aksionari CN' AIR nga heqja dore e kerkimit te shumes prej 5,511,527 euro ose 561,700,000 leke kembyer me kursin sipas Bankes se Shqiperise me date 01.01.2023 dhe perthithjes se humbjes ne shumen 500,934,402 leke situata e kapitalit themeltar dhe e zoterimit te tij nga aksionaret paraqitet si ne vijim:

Kapitali themeltar i shoqerise ishte 46,000,000 leke behet 106,765,598 leke. Numri i aksioneve ishte 4,600 aksione behet 60,770 aksione dhe vlera nominale per aksion behet 1,756.88 leke per cdo aksion. Zoterimi i aksioneve per secilin aksionar behet si ne tabelen ne vijim:

Aksionari	Vlera e aksioneve me 01.12.2023	Numri i aksioneve i secilit aksionar	Perqindja e zoterimit te aksioneve pas ndryshimeve
CN' AIR	102,805,590	58,516	96.29%
Ylliad	3,960,008	2,254	3.71%
Total	106,765,598	60,770	100%

Diana YLLI (GOLEMI)
Me respekt

Tirane më, 05 dhjetor 2023



mazars

Ermin Duraku Str., Binjaket Build,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUI: K32123006W

Auditues Ligjor

¹ Efekti korrekt nga kursi i kembimit eshte (67,846,881) Lek, por per arsye te rrrumbullakimit ne perlllogaritje eshte marre (67,881,713) Lek

PASQYRA E LLOGARITJEVE TE AKSIONEVE TE KAPITALIT PER EFEKTE TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR DHE ZVOGELIMIT PER MBULIMIN E HUMBJEVE TE MBARTURA.

	<u>Shuma e</u> <u>Detyrimit ne Euro</u>	<u>Shuma e</u> <u>Detyrimit ne All</u>
Detyrimi deri 31/12/2022	5,511,527	629,581,713
Shlyerje nga 01/01/2023 deri ne date 01/12/2023	-	-
Efekte nga kursi I kembimit	-	(67,881,713)
Gjendja e detyrimit ne 01/12/2023	<u><u>5,511,527</u></u>	<u><u>561,700,000</u></u>

KAPITALET E VETA TE SHOQERISE	Totali i Kapitaleve te Veta 31.12.2022	Zmadhimi i kapitalit themeltar	Totali i Kapitalit pas zmadhimit	Zvogelimi i kapitalit themeltar	Totali i Kapitalit pas zmadhimit dhe zvogelimit
Kapitali i Nenshkruar	46,000,000	561,700,000	607,700,000	(500,934,402)	106,765,598
Rezervat ligjore			-		
Fitime/humbje te mbartura	(500,934,447)		(500,934,447)	500,934,402	(45)
Fitime/humbje neto 2023	-				
TOTALI	(454,934,447)	561,700,000	106,765,553	-	106,765,598

Llogaritjet per zmadhimin e kapitali themeltar te shoqerise

		<u>Shuma ne Leke</u>	<u>Numri i aksioneve</u>	<u>Vlera nominale per aksion</u>
Kapitali themeltar ekzistues	=	46,000,000	4,600	10,000
Zmadhimi i kapitalit ne 01 dhjetor 2023	+	561,700,000	56,170	10,000
Kapitali I shoqerise pas zmadhimit	=	<u>607,700,000</u>	<u>60,770</u>	<u>10,000</u>

Llogaritjet per zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise

		<u>Shuma ne Leke</u>	<u>Numri i aksioneve</u>	<u>Vlera nominale per aksion</u>
Kapitali themeltar ekzistues	=	607,700,000	60,770	10,000.00
Zvogelimi i kapitalit ne 01 dhjetor 2023	+	(500,934,402)	60,770	(8,243.12)
Kapitali i shoqerise pas zvogelimit	=	<u>106,765,598</u>	<u>60,770</u>	<u>1,756.88</u>

% qe zoteron secili aksionari ne kapital

	Vlera e aksioneve me 31.12.2022		Rritja e kapitalit	Vlera e aksioneve pas rritjes		Zvogelimi i kapitalit	Vlera e aksioneve pas zvogelimit	
		%			%			%
Aksionari CN'AIR	23,460,000	51.00%	561,700,000	585,160,000	96.29%	(482,354,410)	102,805,590	96.29%
Aksionari Ylliad	22,540,000	49.00%	-	22,540,000	3.71%	(18,579,992)	3,960,008	3.71%
Total	46,000,000	100.00%	561,700,000	607,700,000	100.00%	(500,934,402)	106,765,598	100.00%

Hartoi

O. Hoxha

Ekonomist

Miratoi

[Signature]



Menaxher i Pergjithshem

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PER QELLIM TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR

1. Te dhena te Pergjithshme mbi Shoqerine

Shoqëria "WEnerg" sh.a është regjistruar pranë QKB me datë 18.09.2009 me NIPT K92118019L. Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Veprimtaria kryesore tregtare e Shoqërisë është planifikim, projektim, financim, ndërtim, testim, transferim, funksionim dhe mirembajtje të Hidrocentralit "Dardha 1" në Pukë si dhe shitjen e energjisë elektrike të prodhuar prej tij. Wenerg sha është licënsuar nga ERE për prodhimin dhe tregëtimin e energjisë elektrike.

2. Te Dhena Per Zmadhimin e Kapitalit

Per realizimin e aktivitetit te saj shoqeria gjate dhe para vitit ushtrimor ka detyrime per aksionarin e saj shoqerine "CN' AIR.

Aksionaret e shoqerise me qellim realizimin e objektit te aktivitetit te shoqerise kane vendosur te rrisin kapitalin e shoqerise nepermjet perfshirjes ne kapital te detyrimit qe shoqeria i ka deri ne date 01.12.2023, perkatesisht ne shumen 561,700,000 leke per ta perdorur per shlyerjen e aksioneve te reja qe do te emetohen nga shoqeria. Si dhe zvogelimin e kapitalit nepermjet perthithjes se humbjeve te mbartura ne vleren 500,934,402 Leke.

Per kete qellim Asambleja e aksionareve me vendimin me date 01.12.2023, ka marre vendimin per zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

3. Politikat Kontabel Per Pasqyrimin e Huave ne Pasqyrat Financiare

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

3.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

3.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.